


MMXXV

NJIHNI TË DREJTAT TUAJA



**TË DREJTAT E
QYTETARËVE
DHE KOMPETENCAT
E PËRGJEGJËSITË
E POLICISË
NË KOSOVË**



Kjo broshurë është përgatitur nga organizatat e shoqërisë civile për të ndihmuar qytetarët të kuptojnë të drejtat e tyre dhe përgjegjësitë e Policisë së Kosovës. Ajo trajton gjithashtu shqetësimet lidhur me sjelljen e policisë dhe përshkruan mekanizmat e llogaridhënies që janë në dispozicion. Përmbajtja bazohet në Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë dhe Kodin e Etikës së Policisë së Kosovës²

¹ Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, në dispozicion në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, [në shqip] <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>; [në serbisht] <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>; [në anglisht] <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>

² Kodi i Etikës së Policisë së Kosovës, në dispozicion këtu: <https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2020/07/Kodi-i-etikes.pdf>

AUTORITETI DHE DETYRAT E POLICISË



- **Baza ligjore:** Baza ligjore: Autoriteti i policisë në Kosovë përkufizohet me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë. Gjithashtu, Kodi i Etikës së Policisë së Kosovës përcakton standardet morale, etike dhe profesionale që priten nga pjesëtarët e policisë.

Pjesëtarët e policisë kanë për detyrë të mbrojnë jetën dhe pronën, të parandalojnë krimin dhe të ruajnë rendin dhe sigurinë publike.

- **Policia e Kosovës është e autorizuar:**

- ✓ Të japë dhe të zbatojë urdhra të ligjshëm;
- ✓ Të patrullojë dhe të sigurojë kufijtë, aeroportet dhe hapësirat;
- ✓ Të mbrojë lokalitetet e trashëgimisë fetare dhe kulturore;
- ✓ Të veprojë edhe jashtë orarit të punës në raste emergjence apo kur kërkohet me ligj.

- Pjesëtarët e policisë mund të kontrollojnë dokumentet dhe të hyjnë në prona pranë zonave kufitare; megjithatë, ata nuk kanë të drejtë të hyjnë në banesa private pa autorizim ligjor.

TË DREJTAT E QYTETARËVE GJATË NDËRVEPRIMIT ME POLICINË



● **Identifikimi:** Pjesëtarët e policisë duhet të identifikohen dhe të paraqesin distinktivin zyrtar, përveç rasteve kur kjo do të përbënte rrezik të menjëhershëm.

Shpjegimet: Qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin shpjegime për veprimet e policisë.

Proporcionaliteti: Të gjitha veprimet e policisë duhet të jenë të domosdoshme, proporcionale dhe të respektojnë të drejtat e njeriut.

E drejta për informim: Policia duhet të informojë individët për çdo pretendim apo dyshim ndaj tyre.

PËRDORIMI I FORCËS DHE KONTROLLET



● Përdorimi i forcës:

- ✓ Lejohet vetëm kur është rreptësisht e nevojshme dhe në proporcion me situatën;
- ✓ Mund të përfshijë forcë fizike, shufra gome, spërkatës irritues, armë zjarri dhe automjete policie;
- ✓ Pjesëtarët e policisë duhet të vlerësojnë me kujdes situatën, duke marrë parasysh shkallën e rrezikshmërisë, si dhe gjendjen fizike, mendore dhe emocionale të individit të përfshirë.

● Armët e zjarrit:

- ✓ Lejohet të përdoren vetëm si mjet i fundit;
- ✓ Përpara përdorimit duhet të jepen paralajmërime verbale, përveç rasteve të rrezikut të menjëhershëm për jetën.

● Kontrollet parandaluese:

- ✓ Policia mund të kontrollojë individët ose pronat nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm për rrezikshmëri;
- ✓ Qytetarët kanë të drejtë të marrin një raport me shkrim për kontrollin dhe të paraqesin ankesë.

● Mbikëqyrja:

- ✓ Një komision i specializuar duhet të shqyrtojë të gjitha rastet e përdorimit të forcës për të siguruar ligjshmërinë e veprimeve dhe llogaridhënien nga pjesëtarët përkatës.

NJIHNI TË DREJTAT TUAJA

NDALIMI I PËRKOHSHËM DHE KUFIZIMET E LËVIZJES



● Ndalimi:

- ✓ Ndalimi i përkohshëm lejohet deri në 6 orë dhe mund të zgjatet në situata emergjence;
- ✓ Personat e ndaluar duhet të informohen për të drejtat e tyre, përfshirë të drejtën për përfaqësim ligjor;
- ✓ Të ndaluarit kanë të drejtë të njoftojnë menjëherë një anëtar të familjes.

● Kufizimet e lëvizjes:

- ✓ Policia mund të kufizojë përkohësisht lëvizjen për arsye sigurie ose mbrojtjeje;
- ✓ Këto kufizime duhet të hiqen menjëherë sapo të arrihet objektivi përkatës.

RAPORTIMI I SJELLJES SË PARREGULLT DHE SIGURIMI I LLOGARIDHËNIES



● Mekanizmat e llogaridhënies:

- ✓ Masat disiplinore për sjellje të keqe rregullohen me ligj;
- ✓ Qytetarët mund të paraqesin ankesa në Inspektoratin Policor të Kosovës;
- ✓ Ankesat mund të dorëzohen në Këshillat Komunalë të Sigurisë.

● Kodi i Etikës:

- ✓ Pjesëtarët e policisë janë të detyruar të zbatojnë parimet e paanshmërisë, respektit, transparencës dhe llogaridhënies.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është institucion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që funksionon në mënyrë të pavarur nga Policia e Kosovës. IPK ka mandatin për të hetuar veprat penale të kryera nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, pa marrë parasysh pozitën apo gradën, gjatë apo jashtë orarit të punës. Ai gjithashtu kryen inspektime të incidenteve disiplinore me profil të lartë që përfshijnë punonjës të Policisë së Kosovës.³

³ Më shumë informacione rreth IPK janë në dispozicion këtu: <https://ipk.rks-gov.net/>

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE JO-SHUMICË



● Trajtimi i barabartë:

- ✓ Pjesëtarët e policisë janë të detyruar të trajtojnë të gjithë qytetarët në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, pa dallim, pavarësisht nga përkatësia etnike, feja, gjuha apo bindjet politike. Inspektoratin Policor të Kosovës;

● Bashkëpunimi në komunitetin:

- ✓ Pjesëtarët e policisë bashkëpunojnë ngushtë me Këshillat Komunalë të Sigurisë dhe komunitetet lokale për të adresuar çështjet e sigurisë publike dhe për t'iu përgjigjur shqetësimeve të komunitetit.

KODI I ETIKËS: PARIMET KRYESORE



Bazuar në Kodin e Etikës së Policisë së Kosovës, detyrimet themelore të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës janë sa vijon:

- ✓ Të trajtojnë të gjithë individët në mënyrë të barabartë, pa dallim, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjinia, feja ose bindjet politike;
- ✓ Të respektojnë dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në çdo veprim;
- ✓ Të veprojnë pa paragjykitime, diskriminim apo favorizime;
- ✓ Të kryejnë detyrat me ndershmëri, të shmangin korrupsionin dhe të jenë llogaridhënës për veprimet e tyre;
- ✓ Të jenë transparentë dhe të informojnë publikun, përveç rasteve kur dhënia e informacioneve kufizohet me ligj;
- ✓ Të sigurojnë që veprimet e tyre të jenë të ligjshme, proporcionale dhe pa përdorim të tepruar të forcës;

- ✓ Të përfaqësojnë karakterin multi-etnik të Kosovës dhe të promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore;
- ✓ Të refuzojnë urdhrat e kundërligjshëm dhe t'i raportojnë menjëherë përmes kanaleve përkatëse;
- ✓ Kurrë të mos përfshihen në torturë a trajtim poshtërues, apo të tolerojnë veprimet e tilla, në asnjë rrethanë.

ÇFARË TË BËNI NËSE KENI PËRJETUAR KEQTRAJTIM NGA POLICIA E KOSOVËS



- **Dokumentoni incidentin:** Shkruani sa më shpejt të jetë e mundur të gjitha detajet — vendin, orën, dhe emrat apo numrat e distinktivit të pjesëtarëve të policisë të përfshirë në incident. Merrni informacionin e kontaktit të dëshmitarëve, nëse ka.
- **Kërkoni identifikim:** Kërkoni nga pjesëtari i policisë dokumentin e identifikimit ose numrin e distinktivit, nëse nuk ju është dhënë gjatë ndërveprimit.
- **Paraqitni ankesë:** Raportoni incidentin në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) ose paraqitni ankesë përmes Këshillit Komunal të Sigurisë. Mund të kërkonti ndihmë ligjore edhe nga organizatat e të drejtave të njeriut.
- **Kërkoni kujdes mjekësor:** Nëse jeni lënduar, kërkonti menjëherë ndihmë mjekësore. Sigurohuni që lëndimet tuaja të dokumentohen zyrtarisht nga një profesionist i kujdesit shëndetësor.
- **Raportoni diskriminimin:** Nëse përjetoni diskriminim, keqtrajtim apo trajtim çnjerëzor për çfarëdo shkak, mund të kontaktoni Institucionin e Avokatit të Popullit, sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

SI HARTOHET NJË ANKESË ME SHKRIM



Nëse keni përjetuar keqtrajtim apo abuzim nga Policia e Kosovës, është e rëndësishme që incidenti të dokumentohet dhe të parashtrohet një ankesë. Gjatë hartimit të ankesës tuaj, sigurohuni të përfshini sa vijon:

- ✓ Emrin dhe mbiemrin tuaj të plotë, adresën, informacionet e kontaktit dhe datën;
- ✓ Adresoni letërën tuaj Inspektoratit Policor të Kosovës ose autoritetit përkatës komunal;
- ✓ Jepni një përshkrim të qartë dhe të detajuar të incidentit — duke përfshirë datën, orën, vendndodhjen dhe emrat ose numrat e distinktivëve të pjesëtarëve të policisë të përfshirë në incident;
- ✓ Renditni emrat e dëshmitarëve dhe informacionet e tyre të kontaktit;
- ✓ Përcaktoni qartë veprimin që po kërkonti, siç mund të jetë: hetimi i rastit, masa disiplinore ose një kërkim-falje formale;
- ✓ Bashkëngjitni çdo provë që keni në dispozicion, si fotografi, raporte mjekësore apo dokumente të tjera mbështetëse;
- ✓ Sigurohuni që letra të jetë e nënshkruar dhe të ketë datën përkatëse.

Ankesat mund të dorëzohen edhe online përmes uebsajtit të Inspektoratit Policor të Kosovës në këtë link:

→ [HTTPS://IPK.RKS-GOV.NET/REPORTING/REPORTING](https://ipk.rks-gov.net/reporting/reporting)



SJELLJA E PARREGULLT E POLICISË DHE MASAT DISIPLINORE



Pjesëtarët e Policisë së Kosovës i nënshtrohen masave disiplinore në rast të shkeljeve të ligjit apo të standardeve etike. Këto shkelje kategorizohen si më poshtë:

Shkelje të lehta: Komunikimi i papërshtatshëm, vonesa në detyrë, mosrespektimi i rregullave për uniformë dhe sjellja mosrespektuese;

Shkelje të rënda: Abuzimi i autoritetit, përdorimi i tepruar i forcës, diskriminimi, falsifikimi i raporteve dhe mospërfillja e procedurave ligjore;

Shkelje shumë të rënda: Aktet e korrupsionit, ushtrimi i dhunës me pasoja të dëmshme, ngacmimi, tortura apo çdo formë trajtimi poshtërues.

TË DREJTAT E QYTETARËVE GJATË RAPORTIMIT TË SHKELJEVE:



Anonimiteti: Qytetarët mund të bëjnë kallëzime në mënyrë anonime, nëse kanë frikë nga hakmarria apo druajnë pasoja të tjera.

E drejta për informim: Qytetarët kanë të drejtë të marrin informacione të përditësuara mbi procesin dhe rezultatet e hetimeve.

Mbështetja ligjore: Shërbimet e ndihmës juridike dhe këshillimit janë në dispozicion për viktimat e keqtrajtimi nga policia.

E DREJTA PËR TË PËRDORUR GJUHËN TUAJ



Sipas nenit 5 të Kushtetutës së Kosovës, gjuha shqipe dhe gjuha serbe njihen si gjuhë zyrtare të barabarta. Kjo do të thotë se gjuha serbe ka status kushtetues si gjuhë zyrtare dhe jo vetëm status të përcaktuar përmes dispozitave ligjore.

Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, konfirmon se Kosova është shoqëri shumëgjuhëshe. Sipas nenit 2 të këtij ligji: "Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës" dhe "Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës".

Neni 4 i këtij ligji gjithashtu garanton: "Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga institucionet qendrore të Kosovës në cilëndo gjuhë zyrtare. Të gjitha institucionet qendrore kanë për detyrë të sigurojnë që çdo person mund të komunikojë dhe mund të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga organet dhe institucionet e tyre në cilëndo gjuhë zyrtare."

Kjo do të thotë se ju keni të drejtë të komunikoni me çdo institucion të Kosovës në një nga gjuhët zyrtare, ndërsa institucionet janë të detyruara që çdo komunikim – verbal apo jo-verbal – ta bëjnë në shqip apo serbisht.

KONTAKTET NË RAST EMERGJENCE



Nëse të drejtat tuaja janë shkelur nga pjesëtarët e policisë, mund ta raportoni rastin pa pagesë përmes Linjës Blu:

08000 3333

Ankesat mund të dorëzohen edhe përmes formularit online në uebsajtin e Inspektoratit Policor këtu:



→ [HTTPS://IPK.RKS-GOV.NET/REPORTING/REPORTING](https://ipk.rks-gov.net/reporting/reporting)

Policia e Kosovës - Emergjencia:	192
Inspektorati Policor i Kosovës (IPK):	+383 (0)38 200 19 500
Organizatrat e të drejtave të njeriut:	Kontakttoni zyrën tuaj komunale për ndihmë.

Avokati i Popullit:
 +383 (0) 38 223 782
 +383 (0) 38 223 783
 +383 (0) 38 223 784
 +383 (0) 38 223 789
 E-mail: info.oik@oik-rks.org

**Zyra Rajonale për Ndihmë
 Juridike Falas – Prishtinë**
 038/200 18 944
 038/200 18 941
 Adresa: Zenel Salihu 30, Priština

Agjencia e Kosovës për Ndihmë Juridike Falas

→ [HTTPS://ANJF.RKS-GOV.NET/PAGE.ASPX?ID=3,1,1,1](https://anjf.rks-gov.net/page.aspx?id=3,1,1,1)

INFORMOHUNI, QËNDRONI TË SIGURT!

Për më shumë informacion, vizitoni uebsajtin zyrtar të Policisë së Kosovës: [<https://www.kosovopolice.com/sr/>] apo kontaktoni stacionin tuaj lokal të policisë.